GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, divizioni civil, në trup gjykues, i përbërë nga gjykatësi **Agim METBALA,** si kryetar i turpit gjykues, gjykatësve porotë – Aliriza Sokoli dhe Mustafë Cena, si anëtarë të trupit gjykues, në çështjen juridike të propozuesve A. D. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Z. Z., po ashtu nga Rahoveci, dhe F. D. e lindur K. nga Rahoveci, për shkak të zgjidhjes të bashkësisë martesore me marrëveshje dhe atë me shkurorëzim, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor si dhe pas këshillimit dhe votimit, më 27.12.2017, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. MIRATOHET propozimi i propozuesve A. D. nga Rahoveci dhe F. D. e lindur K., po ashtu nga Rahoveci dhe **ZGJIDHET** martesa e lidhur mes tyre me datën ..., e cila martesë është regjistruar nën numrin rendor ..., **SI ME BAZË.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit A. D. nga Rahoveci dhe F. D. e lindur K., po ashtu nga Rahoveci, kësaj gjykate i kanë ushtruar propozimin e përbashkët për zgjidhjes e bashkësisë martesore me marrëveshje dhe atë me shkurorëzim.

Në bazë të propozimit të propozuesve, trupi gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 27.12.2017.

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të rendit të parë, avokati Z. Z., në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 27.12.2017, ngeli në tërësi pranë propozimit të përbashkët të ushtruar nga ana e këtu palëve në procedurë, duke shtuar se ata pikërisht me datën ..., pranë zyrës së gjendjes civile në Rahovec, kanë lidhur bashkësinë martesore - janë kurorëzuar, e cila martesë është regjistruar nën numrin rendor ...

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të rendit të parë, më tej ka shtuar se këtu palët në procedurë si bashkëshortë, në fillim i kanë pas raportet bashkëshortore jashtëzakonisht të mira, mirëpo me kalimin e kohës e prej ditës në ditë, ato vazhdimisht janë përkeqësuar të përcjell me grindje të vazhdueshme e të gjitha këto për shkak të karaktereve të ndryshme dhe në fund, kanë vendosur këtë bashkësi martesore ta zgjidhin me marrëveshje dhe atë me shkurorëzim, duke i propozuar trupit gjykues që ta miratoj propozimin e propozuesve në tërësi.

./.

Propozuesja e rendit të dytë, F. D. e lindur K., në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 27.12.2017, ngeli në tërësi pranë propozimit të ushtruar, i ka pohuar të gjitha faktet të paraqitur në propozimin e përbashkët duke i propozuar në fund trupit gjykues që ta miratoj propozimin e përbashkët dhe ta zgjidhë bashkësinë martesore mes saj dhe këtu propozuesin e rendit të parë me marrëveshje dhe atë me shkurorëzim.

Trupi gjykues, zbatoi procedurën e provave e gjatë procedurës së provave, bëri leximin e certifikatës martesore, nr. i serisë M ..., prej datës ..., mori deklaratat e palëve në procedurë e duke marrë për bazë edhe faktet jokontestuese të parashtruara me propozimin e përbashkët, ka vërtetuar faktin relevant se këtu palët në procedurë, pikërisht me datën ..., pranë zyrës së gjendjes civile në Rahovec, kanë lidhur bashkësinë martesore - janë kurorëzuar, e cila martesë është regjistruar nën numrin rendor ..., se në fillim, i kanë pas raportet të mira bashkëshortore, mirëpo me kalimin e kohës e prej ditës në ditë, ato vazhdimisht janë përkeqësuar, saqë në fund, kanë ardhur në përfundim që bashkësinë martesore ta shkëpusin me marrëveshje dhe atë me shkurorëzim.

Duke u nisur nga fakti se në rastin konkret, kemi të bëjmë me propozim të përbashkët të ushtruar nga ana e bashkëshortëve këtu propozuesit A. D. dhe F. D. e lindur K., për zgjidhjen e martesës me marrëveshje e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit mbi familjen i Kosovës, nuk i hetoi faktet sa i përket shkaqeve të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim dhe se martesën e zgjidhi në harmoni me dispozitat e nenit 68 paragrafi 2 të Ligjit të përmendur.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale trupi gjykues e bazoi në harmoni me dispozitat e nenit 457.2 të LPK-së dhe vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, C.nr.402/2017, më 27.12.2017

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES
Agim METBALA

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.